

VENDIM
Nr. 20, datë 3.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 12.3.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (Gj) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 59, pika 4, fjalia e dytë, të Kodit Penal dhe neneve 22, pika 1, shkronja “b” dhe 37, të ligjit nr. 79/2020, datë 25.6.2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 30, 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “d” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 2, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 68 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar pranimin pjesërisht të kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 222, datë 13.12.2022 (*vendimi i dënimit*), ka vendosur dënimin e shtetasit D.D. me një vit e katër muaj burgim, për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i katërt, i Kodit Penal (*KP*). Në aplikim të nenit 59 të KP-së është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe shtetasi D.D. është vënë në provë për një periudhë prej dy vjetësh e tetë muaj, me kusht që gjatë

kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Kundër këtij vendimi shtetasi D.D. ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

2. Prokurori ka nxjerrë urdhrin e datës 13.12.2022 për ekzekutimin e vendimit penal nr. 222, datë 13.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i cili, me shkresën e datës 15.12.2022 i është dërguar Zyrës së Shërbimit të Provës Dibër (*shërbimi i provës*). Kjo e fundit, me shkresën e datës 19.12.2022 i ka dërguar shtetasit D.D. njoftim për t'u paraqitur pranë saj me qëllim përmbushjen e kushteve të vendimit të dënimit të dhënë ndaj tij. Në lajmërim-thirrjen e datës 30.12.2022, të këtij njoftimi të shërbimit të provës, shtetasi D.D. rezulton të ketë nënshkruar personalisht, duke vënë shënimin “*Në gjykatën e Dibrës kemi bërë ankimin e datës 27.12.2022*”.

3. Duke qenë se shtetasi D.D. nuk ka përmbushur kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në vendimin e dënimit, më datë 14.1.2023 shërbimi i provës ka njoftuar prokurorin se nuk mund të vazhdonte mbikëqyrjen e tij dhe bazuar në nenin 62 të KP-së, si dhe nenin 29 të ligjit nr. 78/2020, datë 25.6.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”, ka bërë propozimet përkatëse për çështjen organit të akuzës. Sipas raportit të shërbimit të provës, nga shkresa e datës 10.2.2023, të Komisarariatit të Policisë Dibër, rezulton se shtetasi D.D. nuk ndodhej në territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi ishte larguar jashtë shtetit.

4. Më datë 23.3.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*Prokuroria Dibër*), në bazë të nenit 62 të KP-së dhe nenit 40 të ligjit nr. 79/2020, datë 25.6.2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” (*ligji nr. 79/2020*), ka paraqitur në gjykatë kërkesë për revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të dhënë ndaj shtetasit D.D.

5. Sipas akteve të dosjes gjyqësore rezulton se në seancën gjyqësore të datës 9.5.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*gjykata referuese*) ka vendosur pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) me qëllim kontrollin e papajftueshmërisë me Kushtetutën të nenit 59, pika 4, fjalia e dytë, të KP-së dhe neneve 22, pika 1, shkronja “b” dhe 37 të ligjit nr. 79/2020, duke vlerësuar se këto dispozita ligjore bien në kundërshtim me nenin 30 të Kushtetutës dhe nenin 6, pika 2, të KEDNJ-së.

6. Sipas nenit 59, pika 4, fjalia e dytë, të KP-së “*Afati i provës fillon nga e nesërmyja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim.*”. Neni 22, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 79/2020, parashikon: “*Ekzekutohen me urdhr të gjykatës, menjëherë pas shpalljes: b) vendimi penal për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim, ku përfshihet personi me masë sigurimi arrest, me disponimin e gjykatës për lirin e menjëhershëm të tij.*”. Ndërsa sipas nenit 37 të ligjit nr. 79/2020 “*1. Kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal, i njofton menjëherë prokurorit vendimin e përmbledhur. 2. I dënuari i vënë në provë, gjatë kohës së provës është i detyruar të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata, si dhe të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, vendqëndrimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit. 3. Shërbimi i provës bashkërendon punën dhe informon rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit. 4. Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit kur i dënuari nuk mban kontakte me të apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera të vendosura nga gjykata.*”.

7. Kolegji i Gjykatës, më datë 19.9.2023, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, më datë 9.10.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. *Gjykata referuese*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

A. *Për legjitimitimin*

8.1 Ajo bën pjesë në kategorinë e subjekteve që mund ta vënë në lëvizje Gjykatën sipas neneve 134 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës dhe 49, pika 3, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, çështja bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe, në rastin konkret, plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e legjitimitit. Çështja e paraqitur për gjykim lidhet me zbatimin e neneve 59, 60, 61 dhe 62 të KP-së, si dhe me nenet 22, pika 1, shkronja “b” dhe 37, të ligjit nr. 79/2020. Vendimi i dënimit i shtetasit D.D., më anë të të cilit ai është vënë në shërbim prove, nuk ka marrë formë të prerë, pasi kundër tij është bërë ankim, ndërkohë që ai është vënë në ekzekutim menjëherë nga prokurori. Në gjykatën referuese është shtruar për diskutim çështja nëse duhet të revokohet vendimi i pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim i dhënë ndaj shtetasit D.D., ndërkohë që vendimi i dënimit nuk ka marrë formë të prerë.

B. Për themelin

8.2 Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, i parashikuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi shtetasi D.D. nuk ka e marrë statusin e të dënuarit, për shkak se vendimi i dënimit të tij nuk ka marrë formë të prerë. Neni 59, pika 4, fjalë e dytë, i KP-së, dhe nenet 22, pika 1, shkronja “b” dhe 37 të ligjit nr. 79/2020 cenojnë këtë parim, pasi nuk mund të nxirret menjëherë urdhri penal nga prokurori, ndërkohë që personi nuk ka marrë statusin e të dënuarit. Kjo dispozitë në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të saj përdor termin “i dënuari” dhe jo “i pandehuri” ose “i gjykuari”, duke nënkuptuar se dënimi alternativ zbatohet ndaj personit që ka fituar këtë status.

8.3 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, për shkak se mënyra e formulimit të dispozitave të kundërshtuara ka sjellë në praktikë zbatimin e menjëhershëm të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë. Po kështu, janë evidentuar raste kur, pasi i dënuari ka përmbushur kushtet dhe afatin e shërbimit të provës gjykatat më të larta e kanë revokuar këtë dënim alternativ, duke disponuar vuajtjen e dënimit me burgim prej tij. KP-ja, Kodi i Procedurës Penale (KPP) dhe ligji nr. 79/2020 nuk parashikojnë rregulla për llogaritjen e afateve për këtë dënim alternativ, sikurse parashikohet në nenin 57 të KP-së për dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe dënimin alternativ të kryerjes së një pune me interes publik.

9. Subjekti i interesuar, Kuvendi, nuk ka paraqitur prapësime, edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

10. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

A. Për legjitimitimin

10.1 Gjykata referuese nuk plotëson kriteret kumulative të përcaktuara nga neni 145, pika 2, i Kushtetutës. Ajo nuk legjitimohet *ratione materiae* pasi nuk ka përcaktuar se cilat janë dispozitat e zbatueshme në çështjen konkrete në shqyrtim përpara saj. Dispozitat e kundërshtuara nuk prekin fajësinë e të akuzuarit, por lidhen me një fazë që i takon ekzekutimit të dënimit penal. Gjykata referuese nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të marrë në shqyrtim nëse ka dispozita të tjera për zgjedhjen e çështjes konkrete dhe nuk i bazon kërkimet në çështjen konkrete, por në praktikën gjyqësore. Përpara saj është paraqitur për gjykim çështja e revokimit të vendimit për caktimin e dënimit alternativ, për shkak se i akuzuari nuk ka përmbushur detyrimet e tij, ndaj dispozitat e kundërshtuara nuk lidhen me mënyrën e disponimit në këtë fazë të gjykimit, por me fillimin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit për caktimin e dënimit alternativ të vënies në provë. Gjykata referuese ka në dispozicion mekanizma të tjerë ligjorë për zgjedhjen e çështjes.

10.2 Gjykata referuese nuk ka sjellë asnjë argument se përse përmbajtja e dispozitave të kundërshtuara cenon parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të sigurisë juridike. Neni 59, pika 4, fjalë e dytë, i KP-së nuk ka parashikuar se dhënia e vendimit i referohet gjykatës së shkallës së parë, pra nuk parashikon ekzekutimin e vendimit pa marrë formë të prerë. Edhe neni 22, shkronja “b”, i ligjit nr. 79/2020 nuk parashikon në asnjë rrethanë të saj fillimin e ekzekutimit të dënimit

alternativ pa marrë formë të prerë, por të lirit të menjëhershëm të personit kur ka qenë nën një masë sigurimi personal.

B. Për themelin

10.3 Neni 59 i KP-së është interpretuar në mënyrë të gabuar, pasi nuk u referohet vendimeve penale të gjykatës së shkallës së parë, të cilat nuk ekzekutohen pa marrë formë të prerë. Ai nuk parashikon në mënyrë të shprehur shkallën e gjykatës, në nivel hierarkik, vendimi i së cilës ekzekutohet, por e lidh me momentin e afatit të fillimit të provës. Termi “gjykata që ka dhënë vendimin” nuk duhet të lidhet në kuptimin e ngushtë me çdo gjykatë që jep vendimin, pavarësisht se është i ekzekutueshëm ose jo. Rregullat bazë për ekzekutimin e vendimeve penale nuk preken nga kjo dispozitë. Në këtë rast, vendimi që do të vihet në ekzekutim do të jetë ai i shkallës së parë nëse nuk është ushtruar ankim ose ankimi nuk është pranuar. Neni 462 i KPP-së parashikon se vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë si rregulli bazë i ekzekutimit të vendimeve. Në këtë kuptim, problematika ka lindur në praktikë për zbatimin e normës dhe jo përmbajtjen e saj.

10.4 Referuar dispozitave të ligjit nr. 79/2020, në asnjërën prej tyre nuk citohet se prokurori ose shërbimi i provës ekzekutojnë menjëherë vendimet për caktimin e dënimeve alternative edhe para se të marrin formë të prerë. Referuar nenit 22, shkronja “b”, të atij ligji, masa e sigurimit bie menjëherë pasi personi nuk mund të vijojë të qëndrojë në paraburgim ose në arrest shtëpie, ndërkohë që gjykata është shprehur për pezullimin e dënimit me burgim dhe vendosjen e një mase lehtësuese në raport me dënimin me burgim. Pra, ekzekutimi i menjëhershëm nuk lidhet me dënimin alternativ në vetvete, por me masën e sigurimit personal. As kjo dispozitë nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe problematika ka lindur për zbatimin dhe jo për përmbajtjen e saj.

10.5 Të njëjtat argumente vlejné edhe për nenin 37 të ligjit nr. 79/2020, i cili nuk parashikon ekzekutimin e dënimit përpara se të marrë formë të prerë, por ekzekutimin pas marrjes së vendimit të përmbledhur për personin e dënuar. Në këtë rast, personi duhet të ketë marrë statusin e personit të dënuar me vendim të formës së prerë. Fakti që ligji përmend termin “menjëherë” nuk i referohet ekzekutimit të menjëhershëm të vendimeve penale, pasi rastet e ekzekutimit të menjëhershëm janë shteruese dhe ekzekutimi i dënimeve alternative nuk është pjesë e tyre. Vendimet e gjykatave të shkallës së parë mund të ekzekutohen vetëm nëse ndaj tyre nuk është bërë ankim ose kanë kaluar afatet e ankimit, ndërsa vendimet e gjykatave të apelit janë të ekzekutueshme edhe në rast kur ndaj tyre është paraqitur rekurs.

11. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

A. Për legjitimitimin

11.1 Gjykata referuese legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës, pasi bën pjesë në kategorinë e subjekteve të parashikuara nga neni 134 i Kushtetutës dhe neni 49, pika 3, shkronja “dh”, i ligjit nr. 8577/2000. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, çështja bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe në rastin konkret plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e legjitimitimit.

B. Për themelin

11.2 Përmbajtja e nenit 59, pika 4, fjalë e dytë, të KP-së, është e papajtueshme me Kushtetutën, pasi cenon *parimin e prezumimit të pafajësisë*. Referuar rastit konkret të paraqitur për gjykimin në gjykatën referuese, shtetasi D.D. nuk ka marrë ende statusin e të dënuarit, pasi vendimi për dënimin e tij nuk ka marrë formë të prerë dhe, në këtë kuptim, ai prezumohet i pafajshëm. Ndryshe nga sa parashikon kjo dispozitë nuk mund të nxirret menjëherë urdhri i ekzekutimit nga prokurori, për sa kohë që personi është ende me statusin e të pandehurit. Në përmbajtjen e nenit 59 të KP-së përdoret termi “i dënuar”, duke nënkuptuar se dënimi alternativ zbatohet ndaj personit që e ka fituar këtë status. Në mungesë të parashikimit të kësaj dispozite është plotësisht i zbatueshëm neni 22 i ligjit nr. 79/2020, pasi ka të bëjë me ekzekutimin e menjëhershëm, kur gjykata urdhëron

menjëherë pas shpalljes me shkurtim vendimi, për raste që kanë të bëjnë me disponimin e saj për lirin e personit të paraburgosur.

11.3 Dispozita e kundërshtuar e KP-së cenon edhe *parimin e sigurisë juridike*, pasi mënyra e formulimit të dispozitave të kundërshtuara ka sjellë në praktikë zbatimin e menjëhershëm të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë. Ka pasur mjaft raste në praktikë kur i dënuari ka përmbushur kushtet në afatin e shërbimit të provës, ndërkohë që Gjykata e Lartë e ka revokuar këtë dënim alternativ, duke disponuar me vuajtjen e dënimit me burgim.

11.4 Sipas nenit 462 të KPP-së, vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë. Kjo dispozitë ka përcaktuar se cilat vendime konsiderohen të formës së prerë dhe se mënyra e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet me ligj të veçantë. Për këtë qëllim ligji nr. 79/2020 në nenin 22 të tij ka përcaktuar se cilat vendime janë të ekzekutueshme menjëherë pas shpalljes, ndërsa në nenin 37 ka parashikuar detyrimet që duhet të përmbushë personi që vihet në provë ndaj shërbimit të provës, ashtu edhe detyrimet e këtij të fundit. Nenet 22 dhe 37 të ligjit nr. 79/2020 nuk bien në kundërshtim me Kushtetutën pasi ato veprojnë për situata të tjera procedurale të parashikuara nga KPP-ja.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

12. Gjykata referuese ka parashtruar se ajo legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi incidental në kuptim të përmbajtjes së neneve 134 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 49, pika 3, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000. Të njëjtat argumente për legjitimitimin e gjykatës referuese janë parashtruar edhe nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme.

13. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se gjykata referuese nuk legjitimohet pasi nuk ka përcaktuar se cilat janë dispozitat e zbatueshme në rastin konkret në shqyrtim përpara saj dhe nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të identifikuar nëse ka dispozita të tjera për zgjidhjen e çështjes konkrete, por i bazon pretendimet mbi bazën e praktikës gjyqësore. Sipas këtij subjekti, dispozitat e kundërshtuara nuk lidhen me mënyrën e disponimit në këtë fazë të gjykimit, por me fillimin e ekzekutimit dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit për caktimin e dënimit alternativ të vënies në provë, ndaj gjykata ka në dispozicion mekanizma të tjerë ligjorë për zgjidhjen e çështjes. Sipas tij, edhe neni 22, shkronja “b”, i ligjit nr. 79/2020 ka të bëjë me personat që ndodhen nën një masë sigurimi personal dhe gjykata e shkallës së parë cakton një dënim alternativ në vendimin përfundimtar të saj dhe kjo dispozitë nuk parashikon në asnjë rrethanë të saj fillimin e ekzekutimit të dënimit alternativ pa marrë formë të prerë, por të lirit të menjëhershëm të personit kur ka qenë nën një masë sigurimi personal. Sipas Këshillit të Ministrave, të njëjtat argumente vlejnë edhe për nenin 37 të ligjit nr. 79/2020, i cili nuk parashikon ekzekutimin e dënimit përpara se të marrë formë të prerë, por ekzekutimin pas marrjes së vendimit të përmbledhur për personin e dënuar.

14. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, është shprehur se gjykata referuese legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës dhe se përmbajtja e nenit 59, pika 4, fjalë e dytë, të KP-së, duhet t’i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Sipas këtij subjekti, në lidhje me nenet 22 dhe 37 të ligjit nr. 79/2020, i pari përcakton se cilat vendime janë të ekzekutueshme menjëherë pas shpalljes, ndërsa i dyti parashikon detyrimet që duhet të përmbushë personi që vihet në provë ndaj shërbimit të provës, ashtu edhe detyrimet e këtij të fundit. Sipas tij, situatat procedurale që rregullojnë këto dispozita të ligjit janë të ndryshme nga ajo që rregullon neni 462 i KPP-së në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e procesit kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental parashikohet në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, i cili u njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligjet bien

në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, të vendosin pezullimin e gjykit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e normës. Kjo dispozitë, e konkretizuar edhe në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, lidhet me kontrollin kushtetues të ligjeve nga Gjykata, kur ky kontroll kërkohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

16. Për sa i takon legjitimitet të gjykatës referuese që vë në lëvizje kontrollin incidental të kushtetutshmërisë së normës ligjore, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, të konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka zhvilluar disa kriteret kumulative, sipas të cilave, gjykata referuese duhet që gjatë gjykit që zhvillohet pranë saj: (i) të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e tij dhe të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja në Gjykatë - pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; (ii) të ketë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iii) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 32 datë 30.5.2023; nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 8, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në vijim, për të arritur në përfundimin nëse gjykata referuese ka plotësuar kriteret e mësipërme të legjitimitetit për vënien në lëvizje të gjykit incidental të normës, Gjykata do të ndalet në analizën e secilit prej tyre.

i) Për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjen e drejtpërdrejtë mes tij dhe çështjes kushtetuese

18. Lidhur me këtë kriter të legjitimitetit, Gjykata ka theksuar se gjykata referuese duhet të arsyetojë efektin e drejtpërdrejtë që ka dispozita e kundërshtuar për gjykimin pranë saj, duke individualizuar se pikërisht ajo dispozitë zbatohet dhe zgjidh mosmarrëveshjen konkrete pranë saj. Kjo nënkupton se kriteri për identifikimin e dispozitave ligjore, që gjykata referuese çmon se bien ndesh me Kushtetutën, nuk konsiderohet i plotësuar thjesht me paraqitjen e tyre formalisht në kërkesë, pasi ato duhet të jenë identifikuar dhe individualizuar se zgjidhin mosmarrëveshjen konkrete pranë saj. Dispozita e kundërshtuar duhet të ketë lidhje me gjykimin në gjykatën referuese në atë masë që ai nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shqyrtuar nga Gjykata kushtetutshmëria e dispozitës ligjore (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 30, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, gjykata referuese është vënë në lëvizje për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë Dibër për revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit të shtetasit D.D., i cili është dënuar me një vit e katër muaj burgim për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i katërt, i KP-së, ekzekutimi i të cilit, në zbatim të nenit 59 të po këtij kodi, është pezulluar duke u vënë ky shtetas në provë për një periudhë prej dy vjetësh e tetë muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Gjykata referuese, duke vënë në dyshim kushtetutshmërinë e përmbajtjes së nenit 59, pika 4, fjalia e dytë, të KP-së dhe të neneve 22, pika 1, shkronja “b” dhe 37, të ligjit nr. 79/2020, ka pezulluar gjykimin përpara saj dhe ka vënë në lëvizje gjykimin incidental të këtyre dispozitave ligjore, me pretendimin se bien ndesh me parimet e prezumimit të pafajësisë dhe të sigurisë juridike, të garantuara respektivisht nga nenet 30 dhe 4 të Kushtetutës.

20. Neni 59 i KP-së ka parashikuar se për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Në këto raste gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij kodi. Sipas fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 59, që është edhe dispozita e kundërshtuar nga gjykata referuese, afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Kurse sipas pikës 5 të tij, nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara

në nenin 60, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

21. Në rastin konkret, Gjkata vëren se edhe pse gjykata referuese është vënë në lëvizje me një kërkesë të prokurorit për revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, sipas nenit 62 të KP-së, për shkelje të kushteve dhe të detyrimeve gjatë kohës së provës nga ana e personit ndaj të cilit është urdhëruar zbatimi i këtij dënimi alternativ me burgim, fillimi i kohës/afatit të provës përcaktohet nga përmbajtja e pikës 4 të nenit 59 të KP-së, sipas të cilit koha/afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendimin për pezullimin e dënimit me burgim, dispozitë e cila përcakton edhe kompetencën e gjykatës, ndër të tjera, edhe për revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit në rast se i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të KP-së, siç është urdhëruar nga gjykata, kompetencë e cila i është kërkuar ta ushtrojë në rastin konkret. Edhe pse detyrimet për personin e dënuar me burgim dhe të vendosur në provë janë parashikuar nga neni 60 i KPP-së, kurse masat që mund të merren ndaj tij në rast të shkeljes së kushteve dhe të detyrimeve gjatë kohës së provës parashikohen në nenin 62 të këtij kodi, gjykata referuese ka vënë në dyshim pikërisht kushtetutshmërinë e fjalisë së dytë të nenit 59 të KP-së, në lidhje me ekzekutueshmërinë e menjëhershme të vendimit të gjykatës që nuk ka marrë formë të prerë, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit, e cila është përcaktuese për verifikimin e ekzistencës ose jo për atë të detyrimeve sipas nenit 60 të KP-së, shkelja e të cilave mund të çojë në revokimin prej saj të vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg. Për rrjedhojë, duket që dispozita e kundërshtuar e KP-së ka efekt të drejtpërdrejtë për gjykimin që zhvillohet në gjykatën referuese. Për shkak të ndërlidhjes me dispozitën që i kërkohet të zbatohet në rastin konkret, edhe dispozita e kundërshtuar nuk përjashtohet nga zbatimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes konkrete në gjykatën referuese. Për rrjedhojë, Gjkata çmon se në lidhje me nenin 59, pika 4, fjalia e dytë, të KP-së, gjykata referuese ka përmbushur kriterin e identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë që kushtetutshmëria e tij ka me gjykimin e çështjes në shqyrtim përpara saj, për sa kohë që është e zbatueshme për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi.

22. Për sa u përket dispozitave të tjera ligjore të kundërshtuara në objektin e kërkesës, Gjkata vëren se për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 79/2020, qëllimi i të cilit është të garantojë ekzekutimin e vendimeve penale në përputhje me legjislacionin në fuqi, me standardet ndërkombëtare dhe në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (neni 1), duke pasur ai për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, të vendimeve gjyqësore penale me ekzekutim të menjëhershëm, të urdhërimeve të tjera me vendime gjyqësore, si dhe përcaktimin e mënyrës së kryerjes së dënimeve alternative sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi (neni 2). Në pjesën e tretë të këtij ligji, që rregullon mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale, kreu I i saj bën fjalë për ekzekutimin e vendimeve që nuk kanë marrë formë të prerë, ku neni 22 rregullon ekzekutimin e menjëhershëm dhe sipas pikës 1, shkronja “b”, të tij, ekzekutohen me urdhër të gjykatës, menjëherë pas shpalljes, vendimi penal për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim, ku përfshihet personi me masë sigurimi arrest, me disponimin e gjykatës për lirim të menjëhershëm të tij. Ndërsa kreu II i kësaj pjese bën fjalë për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë dhe të dënimeve alternative, ku neni 37 rregullon ekzekutimin e vendimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, duke parashikuar se kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë, sipas parashikimeve të nenit 59 të KP-së, i njofton menjëherë prokurorit vendimin e përmbledhur (*pika 1*). I dënuari i vënë në provë, gjatë kohës së provës është i detyruar të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata, si dhe të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, vendqëndrimin, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit (*pika 2*). Shërbimi i

provës bashkërendon punën dhe informon rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit (*pika 3*). Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit kur i dënuari nuk mban kontakte me të apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera të vendosura nga gjykata (*pika 4*).

23. Për rrjedhojë, bazuar në përmbajtjen e këtyre dispozitave rezulton se neni 22 i ligjit nr. 79/2020 rregullon ekzekutimin menjëherë të disponimit të gjykatës për lirim të menjëhershëm të personit me masë sigurimi arrest në rastin e një vendimi penal jo të formës së prerë për caktimin ndaj tij të dënimit alternativ të dënimit me burgim, ndërkohë që çështja në shqyrtim përpara gjykatës referuese nuk ka të bëjë me situatën që kjo dispozitë bën fjalë, por me ekzekutimin e vetë vendimit penal jo të formës së prerë për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim. Kurse neni 37 i këtij ligji rregullon ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë të dënimit alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit, duke përcaktuar detyrimet që duhet të përmbushë personi që vihet në provë ndaj shërbimit të provës në kuadër të ekzekutimit, sikundër edhe përgjegjësitë e këtij të fundit për mbikëqyrjen e ekzekutimit. Në këto kushte, nuk duket që këto dispozita janë të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete në shqyrtim nga gjykata referuese, duke qenë i pamjaftueshëm arsyetimi i saj për efektin e drejtpërdrejtë që ato kanë për gjykimin përpara asaj gjykate. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk legjitimohet për kundërshtimin e tyre.

ii) Për parashtimin e arsyeve serioze të antikushtetutshmërisë

24. Gjykata ka theksuar se përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës. Për këtë arsye, kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese (*shih vendimet nr. 73, datë 17.11.2017; nr. 4, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, gjykata referuese duhet të evidentojë jo vetëm objektin, por edhe standardin kushtetues të cenuar në funksion të vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues, pra jo vetëm normën ligjore, por edhe parimet ose standardet kushtetuese që ajo cenon në rast se zbatohet për zgjidhjen e çështjes (*shih vendimin nr. 8, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykata referuese ka pretenduar se neni 59, pika 4, fjalía e dytë, i KP-së cenon parimin e prezumimit të pafajësisë, për shkak se zbatohet edhe ndaj vendimeve që nuk kanë marrë formë të prerë, si dhe parimin e sigurisë juridike, për shkak të paqartësisë në mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se gjykata referuese ka arsyetuar vendimin me të cilin ka bazuar kërkesën për kontroll incidental, duke paraqitur argumente dhe arsye të mjaftueshme për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, për rrjedhojë ka plotësuar edhe këtë kriter të legjitimitetit.

iii) Për përpjekjet për interpretimin e ligjit në përputhje me Kushtetutën

26. Lidhur me këtë kriter, Gjykata ka theksuar se është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Nisur nga parimi i prezumimit të kushtetutshmërisë së normës me Kushtetutën, interpretimi pajtues është i mundur kur një ligj ose dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 33, datë 24.6.2010; nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rast se gjykata referuese vlerëson se çdo interpretim i mundshëm bie në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si të zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimet nr. 69, datë 27.12.2023; nr. 4, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata, duke mbajtur parasysh se shkaqet e kërkesës lidhen me antikushtetutshmërinë e përmbajtjes së nenit 59, pika 4, fjalía e dytë, të KP-së, në drejtim të parimeve të prezumimit të pafajësisë dhe të sigurisë juridike, si dhe analizën e gjykatës referuese për pamundësinë e ndonjë

interpretimi pajtues të kësaj norme, pra të dhënies së një kuptimi që është i pajtueshëm me Kushtetutën, vlerëson se është përmbushur edhe ky kriter i legjitimitetit.

28. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se gjykata referuese plotëson kriteret e legjitimitetit në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000.

29. Gjykata vëren se gjykata referuese ka pretenduar se dispozita e kundërshtuar e KP-së bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë, për shkak se ajo zbatohet edhe për ekzekutimin e vendimeve që nuk kanë marrë formë të prerë, ashtu edhe me parimin e sigurisë juridike, për shkak të paqartësisë në formulim që ka sjellë paqartësi edhe në zbatimin në praktikë nga gjykatat e zakonshme. Gjykata, bazuar në parimin *iura novit curia* vlerëson se pretendimet e gjykatës referuese duhet të shqyrtohen në vijim në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën për ankim efektiv, në këndvështrim të neneve 30 dhe 43 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën për ankim efektiv

30. Sipas gjykatës referuese, shtetasi D.D. nuk e ka marrë statusin e të dënuarit, për shkak se vendimi i dënimit të tij nuk ka marrë formë të prerë, ndaj ai prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia t'i provohet me vendim të formës së prerë dhe për këtë arsye nuk mund të nxirret menjëherë urdhri penal nga prokurori. Gjykata referuese ka pretenduar se neni 59 i KP-së, në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të tij, përdor termin “i dënuari” dhe jo “i pandehuri” ose “i gjykuari”, duke nënkuptuar se dënimi alternativ zbatohet ndaj personit që ka fituar këtë status (të të dënuarit) dhe i akuzuari merr statusin e të dënuarit kur vendimi penal me të cilin është deklaruar fajtor merr formë të prerë. Sipas gjykatës referuese, dispozita e kundërshtuar, për shkak të formulimit të saj jo vetëm që zbatohet edhe ndaj vendimeve që nuk kanë marrë formë të prerë, por, në thelb, ajo ka sjellë pasoja edhe në drejtim të ankimit efektiv, për sa kohë që edhe në rastet kur i dënuari ka përmbushur kushtet dhe afatin e shërbimit të provës ai ka vijuar dënimin me burgim në rast se një gjykatë më e lartë ka revokuar dënimin alternativ.

31. Në mbështetje të pretendimeve të gjykatës referuese është shprehur edhe subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, sipas të cilit neni 59, pika 4, fjalia e dytë, i KP-së bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi përdorimi i termit “i dënuari” në këtë dispozitë nënkupton se dënimi alternativ zbatohet ndaj personit që e ka fituar këtë status dhe se ndryshe nga sa ajo parashikon nuk mund të nxirret menjëherë urdhri i ekzekutimit nga prokurori, për sa kohë që personi është ende me statusin e të pandehurit.

32. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se neni 59 i KP-së është interpretuar në mënyrë të gabuar, pasi ai nuk u referohet vendimeve penale të gjykatës së shkallës së parë, për sa kohë legjislacioni nuk e lejon ekzekutimin e tyre pa marrë formë të prerë. Sipas këtij subjekti, termi “gjykata që ka dhënë vendimin” nuk duhet të lidhet në kuptimin e ngushtë me çdo gjykatë që jep vendimin, pavarësisht se është i ekzekutueshëm ose jo dhe rregullat bazë për ekzekutimin e vendimeve penale nuk preken nga neni 59 i KP-së. Sipas tij, neni 462 i KPP-së parashikon se vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë si rregulli bazë i ekzekutimit të vendimeve dhe, në këtë kuptim, problematika e lindur në praktikë ka të bëjë me zbatimin e normës por jo me përmbajtjen e saj.

33. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë ndalon marrjen e masave ndaj një të pandehuri në

procedurat penale që çojnë në trajtimin e tij si fajtor për sa kohë që kjo fajësi nuk është provuar me vendim të formës së prerë, të dhënë në përfundim të një procedure të parashikuar me ligj.

34. Prezumi i pafajësisë është përcaktuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut si një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6, pika 1, i KEDNJ-së. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi “i akuzuar për një veprë penale” është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12 korrik 2013; Karaman kundër Gjermanisë, datë 27 shkurt 2014*).

35. Kurse sipas nenit 43 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Kjo e drejtë është vlerësuar nga Gjykata si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individi) të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 45, datë 3.7.2017; nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 38, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Garancitë kushtetuese të parimit të prezumimit të pafajësisë janë konkretizuar në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit që procedon me ndjekjen penale (prokurorisë dhe gjykatave) për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi. Në këtë Kod është materializuar, po ashtu, edhe e drejta kushtetuese e ankimit në një gjykatë më të lartë. Neni 410 i KPP-së parashikon të drejtën e ankimit në përgjithësi të të pandehurit, kurse neni 422 i tij parashikon specifikisht të drejtën e tij për të apeluar vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

37. Gjykata vëren se neni 59 i KP-së ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 36/2017, nëpërmjet të cilit, ndërsa është shtuar një paragraf i ri (paragrafi 3), që parashikon se për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata, paragrafi i mëpasshëm, që parashikonte se afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet, është ndryshuar (paragrafi 4 aktual) dhe tashmë, në fjalinë e dytë, parashikon se afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Një parashikim i tillë për nga natyra ka karakter procedural, për sa kohë ka të bëjë me zbatimin, ekzekutimin e një vendimi penal, çka gjen rregullim të gjerë në ligjin procedural penal.

38. Gjykata çmon të evidentojë, fillimisht, se dënimi penal është i lidhur me fajësinë e autorit të veprës penale, pasi është pikërisht fajësia në kryerjen e një veprë penale ajo që imponon zbatimin ndaj autorit të saj të sanksioneve penale, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e të mirave të rëndësishme të shtetit dhe të individit. Këto sanksione janë masa shtrënguese për shkak të kufizimeve që përcaktojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke përfaqësuar ato një nga format e veprimit të shtetit përmes të cilave shoqëria mbrohet nga kriminaliteti.

39. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se sipas fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 59 të KP-së, afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka deklaruar fajësinë dhe ka caktuar dënim me burgim për autorin e veprës penale dhe njëkohësisht ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të këtij dënimi dhe vënien në provë të tij. Nga përmbajtja në tërësi e kësaj dispozite, Gjykata vëren se vendimi për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të personit të gjetur fajtor për veprën penale është kompetencë e gjykatës, duke mos përjashtuar këtu as gjykatën e shkallës së parë. Nisur nga ky lloj interpretimi, një vendim i tillë i kësaj të fundit nuk duket se përjashtohet as nga mënyra e zbatimit sipas fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 59 të KP-së, pra ekzekutimin e tij nga e nesërmja e shpalljes. Parashikimi për ekzekutimin gati menjëherë të një vendimi të tillë të gjykatës së shkallës së parë duket se nuk mban në konsideratë faktin e qenies të ankimueshëm të këtij vendimi në një gjykatë më të lartë dhe nuk mban parasysh as afatet e

ankimit sipas KPP-së, ashtu sikundër edhe faktin se ky vendim i gjykatës së shkallës së parë është potencialisht i cenueshëm nga gjykata më e lartë.

40. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson të ndalet në dispozitat e KPP-së dhe konkretisht në përmbajtjen e nenit 462, pika 3, të tij, sipas të cilit janë vendime të formës së prerë vendimi i gjykatës së shkallës së parë kur nuk ankimohet nga palët brenda afatit ligjor, kur është i paankimueshëm ose kur nuk pranohet ankimi për shkaqet e parashikuara nga neni 420 i këtij kodi, ashtu edhe vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 428 të KPP-së, pra kur vendos lënien në fuqi, ndryshimin ose prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes. Po sipas kësaj dispozite, vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë (*pika 1*), ndërsa, vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes (*pika 2*). Bazuar në këto dispozita, në rastin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që vendos një dënim alternativ, edhe pse ai pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim, në kuptim të nenit 462 të KPP-së, nuk jemi përpara ndonjë prej rasteve kur vendimet e gjykatës së shkallës së parë janë menjëherë të ekzekutueshme. Lidhur me këtë, Gjykata mban parasysh se ekzekutimi i një vendimi penal, në thelb, ka të bëjë me ekzekutimin e sanksioneve penale ose me heqjen e masave të sigurimit personal, ndaj, në këtë kuptim, vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, për sa kohë nuk përmbajnë sanksione penale, ekzekutimi i tyre mbetet të konsistojë vetëm për sa i përket heqjes së masave të sigurimit personal dhe që, për këtë shkak, janë menjëherë të ekzekutueshme.

41. Për sa më sipër, Gjykata thekson se, në kuptim të parimit të prezumimit të pafajësisë, edhe personi i dënuar me vendim të gjykatës së shkallës së parë vijon të konsiderohet i pafajshëm përderisa fajësia e tij nuk është provuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Ai mund të jetë subjekt i kufizimit të lirisë për shkak të masave shtrënguese të sigurimit personal, por jo për shkak të dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë kuptim, ekzekutimi gati menjëherë i vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, e vendos personin në kushtet e përmbushjes së këtij dënimi alternativ me burgim, pikërisht të atyre kufizimeve në liritë dhe të drejtat që lindin nga vënia e tij në provë, pavarësisht faktit se në kuptimin kushtetues vijon të konsiderohet ende i pafajshëm, për sa kohë ai vendim nuk ka marrë formë të prerë. Praktikisht, në pikëpamje të ekzekutimit, një person i pafajshëm në kuptimin kushtetues barazohet me një person fajtor në të njëjtin kuptim, për sa kohë ligji i detyron ata njësoj për të përmbushur detyrimet që vijnë nga një vendim dënimi. Ekzekutimi gati menjëherë i vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim sipas dispozitës së kundërshtuar, pavarësisht faktit se personi ndaj të cilit është dhënë ky dënim alternativ gëzon dhe ka ushtruar të drejtën e ankimit, e paraqet atë në dukje si fajtor përpara gjykatës më të lartë, çka mund të paragjykojë vlerësimin e fakteve nga kjo e fundit dhe të krijojë premisa për mungesën e efektivitetit të ankimit të paraqitur prej tij. Për më tepër, Gjykata mban në konsideratë edhe faktin se ligji nuk parashikon mjet korrigjues, qoftë për llogaritjen e këtij lloji dënimi alternativ të vuajtur, ashtu dhe për kompensimin e individit kur ky dënim gjendet i padrejtë nga gjykata më e lartë. Ndërkohë, në ndryshim nga ky rast, vendimi i dënimit me burgim i gjykatës së shkallës së parë, ekzekutimi i të cilit nuk është pezulluar, nuk e ngarkon personin e dënuar me përmbushjen e detyrimeve përkatëse ndaj shtetit, për sa kohë, ai vendim nuk ka marrë formë të prerë dhe, për këtë arsye, ky person vijon të konsiderohet ende i pafajshëm.

42. Edhe në rastet e ankimeve kushtetuese individuale Gjykata ka vënë në dyshim respektimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese, veçanërisht në ato raste kur gjykata më e lartë ka prishur një vendim të gjykatës më të ulët që kishte zbatuar nenin 59 të KP-së në bazë të të cilit i dënuari kishte zbatuar edhe detyrimet sipas legjislacionit në fuqi. Sipas Gjykatës, me përmbushjen e detyrimeve të caktuara gjatë kohës së provës, vendimi i dënimit alternativ konsiderohet i ekzekutuar sipas ligjit dhe konsiderohet se i dënuari ka vuajtur tërësisht dënimin e caktuar ndaj tij. Ndërkohë, paralelisht me ekzekutimin e vendimit të dënimit alternativ, në rast ankimi, vijon edhe gjykimi i çështjes penale

në lidhje me përcaktimin e fajësisë, në bazë të të cilit do të përcaktohen edhe detyrimet e personit ndaj shtetit. Në këto raste Gjykata ka konsideruar se individ i është ngarkuar të vuajë sërish një pjesë të dënimit me burgim të vuajtur më parë prej tij në një prej mënyrave alternative të këtij dënimi, duke vënë në diskutim cenimin e lirisë personale të tij, si dhe funksionin e dhënies së drejtësisë penale dhe atë riedukativ të dënimit, në kushtet kur ai tashmë e kishte kryer dënimin penal për veprën e kryer (*shih vendimin nr. 24, datë 27.4.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Për sa më lart, Gjykata vlerëson, gjithashtu, se përmbajtja e nenit 59, pika 4, fjalia e dytë, të KP-së vë në dyshim edhe parimin e sigurisë juridike, pasi krijon paqartësi dhe dykuptimshmëri në drejtim të pasojave të vendimit gjyqësor të ekzekutueshëm. Parimi i sigurisë juridike, sipas Gjykatës, ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim kërkohet që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore dhe që sjell pasoja nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Me ndërhyrjen në fjalinë e dytë të pikës 4 të nenit 59 të KP-së ligjvënësi nuk ka respektuar aspektin harmonik që duhet të kenë dispozitat ligjore që rregullojnë një fushë të caktuar, të cilat në tërësinë e tyre duhet të përbëjnë një entitet të vetëm.

44. Po në këtë drejtim, sikurse Gjykata ka theksuar, që ligji të kuptohet saktë dhe drejt, duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata konstaton se në relacionin bashkëshoqërues të ligjit nuk ka argumente të mjaftueshme për domosdoshmërinë e ndërhyrjes për kufizimin e lirisë dhe të drejtave të personit të gjetur fajtor nga gjykata e shkallës së parë përmes ekzekutimit gati menjëherë të vendimit të saj për dhënien e dënimit alternativ me burgim, atij të pezullimit të ekzekutimit të këtij dënimi dhe vënien në provë. Për më tepër, Kuvendi, si subjekt i interesuar në gjykim, nuk ka paraqitur argumente kushtetuese për nevojën, përshtatshmërinë dhe domosdoshmërinë e një ndërhyrjeje të tillë. Në këto kushte, Gjykata vëren paqartësi në qëllimin e parashikimit të bërë përmes asaj fjalie në dispozitën e kundërshtuar, çka është një arsye e cenimit të parimit të sigurisë juridike.

45. Bazuar në analizën si më sipër, Gjykata vlerëson se nuk mund të vihet në ekzekutim një vendim penal i gjykatës së shkallës së parë për dhënien e dënimit alternativ me burgim, atij të pezullimit të ekzekutimit të këtij dënimi dhe vënien në provë të personit të dënuar, në rastin kur ky i fundit ka paraqitur ankim, nëse për atë nuk garantohej respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë dhe e drejta e ankimit efektiv substancial.

46. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën e ankimit efektiv nga përmbajtja e fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 59 të KP-së është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe neneve 68, 70, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 59 të Kodit Penal, me përmbajtje: “Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 3.4.2024.

Shpallur, më 3.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska, Sandër Beci, , Elsa Toska, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim

Anëtar pjesërisht kundër: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të kërkesës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*gjykata referuese*), me të cilën është kërkuar shfuqizimi i nenit 59, pika 4, fjalë e dytë, të Kodit Penal (KP) dhe neneve 22, pika 1, shkronja “b” dhe 37 të ligjit nr. 79, datë 25.6.2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” (*ligji nr. 79/2020*), si të papajtueshme me Kushtetutën, jemi kundër qëndrimit të shumicës për atë pjesë që ka vendosur shfuqizimin e fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 59 të KP-së. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë.

2. Gjykata referuese është duke shqyrtuar një kërkesë të prokurorit për revokimin e dënimit alternativ të caktuar ndaj një individi, të proceduar në gjendje të lirë. Ky i fundit është deklaruar fajtor nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të dhunës në familje, të parashikuar nga neni 130/a, paragrafi i katërt, i KP-së dhe është dënuar me një vit e katër muaj burgim si dhe në bazë të nenit 59 të KP-së i është pezulluar dënimi me burgim, duke u vënë në provë për 2 vjet e 8 muaj. Vendimi penal i gjykatës së shkallës së parë është vënë menjëherë në ekzekutim sipas nenit 59, pika 4, fjalë e dytë, të KP-së. I pandehuri, duke mos qenë dakord me vendimin e fajësisë e ka ankimuar atë dhe nuk është paraqitur pranë Shërbimit të Provës për të përmbushur detyrimet që rridhnin nga alternativa e dënimit me burgim. Në kushtet kur ai nuk ka përmbushur detyrimet e caktuara nga shërbimi i provës, prokuroria ka kërkuar revokimin e dënimit alternativ.

3. Nisur nga këto rrethana, gjykata referuese ka kërkuar kontrollin kushtetues të dispozitave objekt kërkesë. Shumica ka vlerësuar se nenet 22, pika 1, shkronja “b” dhe 37 të ligjit nr. 79/2020, nuk janë dispozita të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete në shqyrtim nga gjykata referuese, ndaj ajo nuk legjitimohet për kundërshtimin e tyre (*shih paragrafin 23 të vendimit*). Ndërsa, për sa i takon nenit 59, pika 4, fjalë e dytë, të KP-së, kërkesja ka përmbushur kriteret e legjitimitetit në drejtim të arsyeve serioze të antikushtetutshmërisë së dispozitës dhe ka bërë të gjitha përpjekjet për interpretimin e ligjit në përputhje me Kushtetutën (*shih paragrafët 25 dhe 27 të vendimit*).

4. Shumica i ka vlerësuar pretendimet në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën për ankim efektiv, në këndvështrim të neneve 30 dhe 43 të Kushtetutës (*shih paragrafin 29 të vendimit*), duke i shqyrtuar këto të drejta kushtetuese edhe në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike.

5. Shumica ka analizuar kuptimin ligjor të vendimit penal të formës së prerë, duke vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë që vendos një alternativë të dënimit me burgim, edhe pse pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim, nuk është menjëherë i ekzekutueshëm. Në këtë kuptim, dispozita e kundërshtuar që urdhëron ekzekutimin menjëherë të vendimit të gjykatës së

shkallës së parë është e paqartë dhe e vendos personin në kushtet e përmbushjes së dënimit alternativ me burgim, edhe pse vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Pra, një person i pafajshëm në kuptimin kushtetues barazohet me një person fajtor, për sa kohë ligji i detyron ata njësoj për të përmbushur detyrimet që vijnë nga një vendim dënimi dhe ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit të gjykatës së shkallës së parë e bën atë të paraqitet si fajtor para gjykatës më të lartë, duke sjellë mundësinë e paragjyqimit të çështjes (*shih paragrafët 40–41 të vendimit*). Mbi bazën e kësaj analize dhe duke mbajtur parasysh rastin kur i gjykuari ka paraqitur ankim, shumica ka vlerësuar se nuk garantohet respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë dhe e drejta e ankimit efektiv substancial, ndaj ka vendosur shfuqizimin e fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 59 të KP-së, si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih paragrafët 45–46 të vendimit*).

6. Nuk pajtohem me këtë konkluzion të shumicës, pasi vlerësojmë se objekti i gjykimit kushtetues lidhet në parim me kategorinë e të pandehurve të lirë, ndaj vendimmarria e Gjykatës duhej të jepte efekte vetëm për ta, sipas arsytimit në vijim.

7. Kontrolli kushtetues incidental lind nga një proces i zakonshëm i gjyqtarit *a quo*, i cili është i bindur se ligji mbi të cilin do të duhet të zgjidhë mosmarrëveshjen konkrete bie ndesh me Kushtetutën. Kjo do të thotë se ky lloj gjykimi kushtetues fillon si kontroll konkret i normës ligjore dhe, për këtë arsye, një prej kriterëve të legjitimitetit të gjykatës *a quo* ka të bëjë me verifikimin nëse norma ligjore e kundërshtuar prej tij është e zbatueshme në faktet konkrete të mosmarrëveshjes gjyqësore që ai po shqyrton. Një arsyetim i kundërt e vendos Gjykatën në vështirësi të vlerësimit kushtetues, sepse e ngarkon me detyrën që të verifikojë të gjithë skenarët e zbatimit të normës ligjore, pa pasur fakte të plota për to. Kjo vështirësi është e shtuar kur objekt i gjykimit është një normë ligjore e një kodi (siç është rasti konkret), pasi kodi përfaqëson një përmbledhje sistematike të normave në një fushë të caktuar, norma të cilat synojnë të kenë një shkallë qëndrueshmërie, të jenë koherente dhe të qarta. Kushtetuta, në nenet 116 dhe 81, pika 2, të saj, njeh rëndësinë dhe natyrën e veçantë të kodeve duke kërkuar një shumicë të cilësuar të votave për miratimin e tyre në Kuvend, si dhe duke i vendosur në një shkallë më lartë në hierarkinë e normave juridike. Lidhur me KP-në, Gjykata ka theksuar se ai përbën një nga ligjet më të rëndësishme, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike dhe miratimi i dispozitave të tij duhet të bëhet me shumicë të cilësuar (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Duke u nisur nga premisa se kontrolli incidental fillon si gjykim konkret, vlerësojmë se kur një çështje kushtetuese e tillë paraqitet për shqyrtim në Gjykatë, kjo e fundit ka detyrimin t'i japë përgjigje asaj referuar procesit që zhvillon gjykata e zakonshme, ndërsa rezultati i gjykimit kushtetues zbatohet në mënyrë abstrakte për të gjitha rastet e tjera të ngjashme. Ky detyrim përligjet nga neni 48, paragrafi 1, i ligjit nr. 8577/200, sipas të cilit Gjykata duhet të respektojë kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Në kuadër të këtij detyrimi, vetë Gjykata ka pohuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 22, datë 11.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, çmujmë se shqyrtimi gjyqësor konkret lind nga një proces i zakonshëm dhe se gjyqtarit *a quo* i intereson zgjidhja e çështjes që ka në shqyrtim dhe jo mundësia abstrakte që ligji është antikushtetues.

9. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, eidentojmë se në parim dispozita e kundërshtuar është e zbatueshme ndaj dy kategorive të të pandehurve përkatësisht: (i) individëve që gjykohen nën masa sigurimi në burgim (përfshirë ata të paraburgosur); (ii) atyre në gjendje të lirë. Ndërkohë, çështja në fjalë e paraqitur nga gjykata referuese ka të bëjë me mundësinë e zbatimit të normës ligjore të kundërshtuar vetëm për të pandehurin në gjendje të lirë. Në këtë situatë edhe kontrolli kushtetues i dispozitës objekt kundërshtimi duhej të fokusohet në kontrollin e të drejtave dhe lirive kushtetuese, përfshirë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtën e ankimit të kësaj kategorie të pandehurish, sikurse është pretenduar nga gjykata referuese. Pikërisht për këtë arsye, bashkohemi me konkluzionin e shumicës se gjykata referuese nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin e nenit 22 të ligjit nr. 79/2020, që parashikon se “ekzekutohen menjëherë pas shpalljes

vendimet penale për caktimin e dënimit alternativ të dënimit me burgim, ku përfshihet personi me masë sigurimi arrest, me disponimin e gjykatës për lirimin e menjëhershëm të tij”. Kjo do të thotë se Gjykata nuk e legjitimoi gjykatën referuese për këtë normë me arsyetimin se mosmarrëveshja gjyqësore që ajo po shqyrtonte nuk kishte të bënte me të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg”. Një arsyetim i ndryshëm për kufijtë e shqyrtimit të çështjes nuk është bindës për moslegjitimimin e gjykatës referuese dhe njëkohësisht krijon përplasje të panevojshme në nivel ligjor me përmbajtjen e nenit 27 të ligjit nr. 79/2020.

10. Referuar standardeve kushtetuese dhe konventore që garantojnë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe së drejtës së ankimit, theksojmë se pafajësia prezumohet deri në momentin kur fajësia provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, ndërsa çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Kjo do të thotë se deklarimi i fajësisë bëhet vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes dhe duke i garantuar të pandehurit të gjitha elementet e procesit të rregullt ligjor, përfshirë të drejtën për t’u mbrojtur në një gjykim të drejtë. E thënë kjo, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe, po ashtu, asnjë masë nuk mund të merret ndaj tij që mund të çojë në trajtimin si fajtor, për sa kohë që fajësia e tij nuk është provuar me vendim të formës së prerë, të dhënë në përfundim të një procedure të parashikuar me ligj. Nga ana tjetër, gjykatat kanë detyrimin të mos shprehen në mënyrë të parakohshme se personi “i akuzuar për një vepër penale” është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjithashtu, të pandehurit, qoftë nën masën e kufizimit të lirisë personale ose në gjendje të lirë, i njihet e drejta e ankimit mbështetur në mundësitë që ai ka për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke iu garantuar në këtë mënyrë e drejta për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Në këtë mënyrë atij i garantohet edhe akses i gjykatë, si një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 45, datë 3.7.2017; nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 38, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Duke iu referuar standardeve të mësipërme dhe kufijve të shqyrtimit të çështjes ndajmë qëndrim të ndryshëm me shumicën, e cila ka kontrolluar kushtetutshmërinë e normës në mënyrë tërësisht abstrakte, duke mos diferencuar situatën e të pandehurve të lirë nga ajo e atyre me masë sigurimi të kufizimit të lirisë. Ne, gjyqtaret në pakicë, jemi të mendimit se qëllimi i ligjvënësist në miratimin e kësaj norme lidhet me kategorinë e të pandehurve që procedohen me masa sigurimi “arrest në burg”, sidomos për të paraburgosurit. Për këtë kategori individësh, ekzekutimi i shpejtë i vendimit, nga e nesërmja e shpalljes së tij, shkon në favor të të drejtave të individit, duke urdhëruar lirimin e tyre të menjëhershëm nga paraburgimi. Kalimi nga gjendja e paraburgimit në gjendjen e lirisë është qëllimi i normës, por, gjithsesi, duke garantuar njëkohësisht nëpërmjet detyrimeve të alternativës së dënimit me burgim, mbarëvajtjen e mëtejshme të procedimit penal dhe ruajtjen e rendit publik. Ndryshe paraqitet situata për kategorinë e të pandehurve të lirë, për të cilët një masë e tillë, në kushtet kur procesi ende nuk ka përfunduar me një vendimmarrje të formës së prerë, i vendos në pozita jofavorizuese. Kjo situatë përkeqësohet veçanërisht kur ata nuk janë të pranishëm dhe nuk kanë mundësinë të shprehin vullnetin ose pëlqimin e tyre për alternativën e dënimit me burgim.

13. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata duhet të ishte mjaftuar me konstatimin se fjalë e dytë e pikës 4 të nenit 59 të KP-së është e pazbatueshme ndaj kësaj kategorie, duke mos e shfuqizuar tërësisht atë. Me fjalë të tjera, shumica duhej të shprehej vetëm për sa i takon kushtetutshmërisë së dispozitës objekt kundërshtimi në zbatimin e saj ndaj personave të pandehur të cilët gjykohen në gjendje të lirë, duke qenë se aplikimi i saj u cenon atyre të drejtat dhe liritë kushtetuese në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe së drejtës së ankimit. Duke mbajtur në konsideratë këtë analizë, arsyetimi për kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitës në fjalë do të duhet të orientonte dhe detyronte ligjvënësin, i cili, brenda hapësirës së tij të vlerësimit, të rishikonte formulimin e

nenit 59, pika 4, fjalia e dytë të KP-së, me qëllim që zbatimi i tij të lidhej vetëm me kategorinë e të pandehurve që gjykohen në masa sigurimi “arrest në burg” apo, eventualisht, me kategorinë e të pandehurve që gjykohen në gjendje të lirë vetëm kur ata janë të pranishëm dhe shprehin pëlqimin e tyre për zbatimin e alternativës së dënimit me burgim.

14. Në përmbledhje të të gjitha argumenteve të mësipërme, vlerësojmë se Gjykata duhej të deklaronte se fjalia e dytë e pikës 4 të nenit 59 të KP-së *“Afati i provës fillon nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim”* nuk duhet të zbatohet për kategorinë e të pandehurve që procedohen në gjendje të lirë, duke e lënë normën pjesë të rendit juridik dhe të zbatueshme për kategorinë e të pandehurve në masë sigurimi “arrest në burg”, përfshirë të pandehurit e paraburgosur.

Anëtarë: Marjana Semini, Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari